



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 24.15.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AGJENCISË SHTETËRORE PËR
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR VITIN E
PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit Valbon Bytyqi, i mbështetur nga Udhëheqësja e ekipit Shehrije Shala dhe Anëtarja e ekipit Ajtene Llapashtica.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	23
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	24
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	27


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Mbikëqyrësin Kryesor Shtetëror dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorin Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 03/12/2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:


Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Mbikëqyrësit Kryesor Shtetëror – auditimi 2015

Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDHP) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PVF-të e ASHMDHP-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të PVF-ve si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë PVF-të prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të ASHMDHP-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF, nr. 03/2013 për PVF-të e organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa, Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e PVF-ve. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të PVF-ve të organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga ASHMDHP dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe PVF-të

Drejtori i Përgjithshëm i ASHMDHIP-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të PVF-ve sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e PVF-ve pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Institucionit të Pavarur.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PVF-ve

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për PVF-të në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse PVF-të nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse PVF-të në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre PVF-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në PVF. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PVF, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në PVF-të nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të PVF-ve.

1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

ASHMDHP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Kërkesat e procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.

Në draft PVF-të ishin të nevojshme disa korrigjime financiare për të cilat ne kemi dhënë sugjerime për të përmirësuar dhe për të siguruar plotësinë e tyre, si:

- Te pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, ndarja buxhetore nga fondi i përgjithshëm (Granti Qeveritar) ishte paraqitur gabimisht në vlerë 348,096€, derisa ndarja e fondit të përgjithshëm ishte 337,167€, me 10,929€ diferencë. I njëjti gabim më pas ishte përcjellë edhe të pjesa e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike; dhe
- Te pasqyra e raportit të ekzekutimit të buxhetit, buxheti final ishte shpalosur gabimisht në vlerë 360,633€, derisa buxheti final ishte 350,950€.

Pas sugjerimeve tona ASHMDHP ka korrigjuar PVF-të e saj dhe versionin final ishte i prezantuar në përputhje me Rregulloren MF- Nr. 03/ 2013 për PVF-të e organizatave buxhetore.

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

ASHMDHP, ka raportuar në përputhje me kornizën ligjore, me përjashtim të raportimit të obligimeve e cila në detaje është prezantuar të kapitulli 3.6.2. Trajtimi i borxheve.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PVF-të.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për ASHMDHP-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

- Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në raport me vitin e kaluar, menaxhmenti i ASHMDHP-së ka bërë përmirësime në aranzhimet e qeverisjes së mirë. Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar ka nxjerrë në pah një raportim të mirë financiar mbi shpenzimet.

Megjithatë, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen edhe më tej, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të Institucionit. Vetëm 1/3 e rekomandimeve të dhëna nga viti i kaluar janë implementuar, derisa pjesa tjetër janë në proces të adresimit ose nuk janë adresuar.

Dobësi kishte edhe në identifikimin dhe menaxhimin e rrezikut, për të identifikuar pengesat e mundshme krahas përmbushjes së objektivave. Kjo reflekton mungesë të llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e regjistrit të rreziqeve si dhe një mungesë njohurie brenda departamenteve për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes në këtë proces.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 të ASHMDHP-së kishte rezultuar me gjashtë rekomandime kryesore. ASHMDHP kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, dy rekomandime janë implementuar, dy janë adresuar pjesërisht, ndërsa dy nuk janë adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 - Niveli i ulët i implementimit të rekomandimeve - Prioritet i lartë

E gjetura Menaxhmenti i ASHMDHP-së ka hartuar planin për implementimin e rekomandimeve, mirëpo adresimi i tyre nuk ishte bërë në pajtueshmëri me planin e veprimit.

Rekomandimet e pa adresuara ndërlidhen me vonesat në ekzekutimin e pagesave si dhe pagesat e të punësuarve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Mbetet sfidë e ASHMDHP-së adresimi i plotë i të gjitha rekomandimeve, përfshirë edhe rekomandimet të cilat janë në proces të adresimit.

Rreziku Mos implementimi i plotë i rekomandimeve nga viti paraprak ka ndikuar në paraqitjen e dobësive të njëjta të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve të tjera në sisteme kyçe financiare me theks të posaçëm në aktivitetet e menaxhimit të personelit.

Rekomandimi 1 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë një plan të rishikuar të veprimit, i cili përcakton qartë një afat kohor dhe stafin përgjegjës për adresimin e të gjitha rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet në baza të rregullta kohore.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese.

Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për ASHMDHP më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

ASHMDHP ka përmbushur kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në listën kontrolluese të vetvlerësimit të përcaktuar nga MF, me përjashtim të hartimit të listës së rreziqeve operationale për vitin 2015 (referoju nënkaptullit 2.5.1. Vlerësimi i rrezikut).

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit ASHMDHP operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në Rregullën Financiare të thesarit 01/2010 - Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli kërkojnë vlerësimin e rrezikut, identifikimin dhe analizimin e rreziqeve relevante ndaj arritjes së objektivave që formojnë bazën për të përcaktuar se si duhet të menaxhohen rreziqet.

Procesi i menaxhimit të rrezikut, shton njohuritë e personelit për kontigjencat që të mund të ndikojnë në arritjen e objektivave dhe ofron një kornizë për të diskutuar rreziqet në të gjitha nivelet brenda organizatës.

Çështja 2 - Moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut – Prioritet i lartë

- E gjetura** ASHMDHP ka kryer vetvlerësimin sipas rregullave të MFK-së, mirëpo ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara për identifikimin e pengesave të mundshme krahas përmbushjes së objektivave.
- Kjo reflekton mungesë të llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e regjistrit të rreziqeve si dhe një mungesë njohurie brenda departamenteve për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për procesin e menaxhimit të rrezikut.
- Rreziku** Proceset e dobëta për identifikimin e rreziqeve reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda organizatës buxhetore, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë.
- Rekomandimi 2** Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë së kanë hartuar një plan për identifikimin, vlerësimin dhe evitimin e rreziqeve të cilat mund të paraqiten gjatë realizimit të objektivave strategjike dhe vjetore, si dhe ka caktuar një person përgjegjës për menaxhimin e rrezikut i cili raporton në baza mujore për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Sa i përket çështjes së raportimeve kemi vërejtur se është një sistem mirë i zhvilluar i raportimit të brendshëm dhe një monitorim i vazhdueshëm.

Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të ASHMDHP-së ka nxjerrë në pah një raportim të mirë financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat si dhe analiza të kompletuara rreth realizimit të buxhetit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Në bazë të kërkesave të udhëzimit administrativ nr. 23/2009, për themelimin dhe funksionimin e njësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik, nga ASHMDHP nuk kërkohet të themelojë këtë njësi. Megjithatë, me qëllim të forcimit të kontrollit të brendshëm, ASHMDHP, kishte lidhë marrëveshje mirëkuptimi me Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ) për përkrahje në lëmin e auditimit të brendshëm.

Bazuar në këtë marrëveshje Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) e MPJ-së kishte përfunduar një auditim më temë: Funksionimi i Administratës në ASHMDHP për periudhën qershor 2014 deri qershor 2015.

Vlerësimi ynë është se raporti i nxjerrë për këtë temë i kishte ofruar menaxhmentit një pasqyrë të qartë mbi nivelin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme, si dhe kishin ofruar nëntë rekomandime për përmirësim të mëtutjeshëm. Pas pranimit të raportit, menaxhmenti kishte ndërmarrë masa dhe ishte në proces të adresimit të rekomandimeve.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarre për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

ASHMDHP në përgjithësi ka kontrollë të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces relativisht të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Realizimi i buxhetit në vitin 2015 ishte në pajtueshmëri me planin e rrjedhjes së parasë. Procedurat e prokurimit publik ishin zhvilluar në përputhje me rregullat e përcaktuara të prokurimit publik, me përjashtim të dobësive në procesimin e pagesave.

Megjithatë, një numër i dobësive duhet të përmirësohen edhe më tej, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të tyre. Numri aktual i të punësuarve ishte më i lartë në raport me numrin e buxhetuar, andaj një pjesë e konsiderueshme e pagave ishte mbuluar nga mallrat dhe shërbimet. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm kishte edhe pozita të mbuluara më ushtrues detyre.

Ndërsa nga aspekti i rëndësisë më të ulët, veprime shtesë nevojiten në menaxhimin e pasurisë (posaçërisht menaxhimin e automjeteve) dhe te raportimi i obligimeve.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore të ASHMDHP-së dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	349,883	350,950	348,713	369,682	371,101
Granti i Qeverisë -Buxheti	349,883	338,754	337,167	369,682	361,811
Donacionet jashtme	-	12,196	11,546	-	9,290

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,066€. Rritja ishte bërë më vendime të Qeverisë.

Në vitin 2015, ASHMDHP ka përdorur 99% të buxhet final, me një realizim pothuajse të njëjtë me vitin 2014. Trendi i shpenzimeve ndërmjet viteve është i ngjashëm dhe nxjerr në pah një nivel të vazhdueshëm dhe konsistent të ekzekutimit të buxhetit sipas planit të rrjedhjes së parasë. Në vijim jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	349,883	350,949	348,712	369,682	371,101
Pagat dhe Mëditjet	212,183	208,358	208,358	183,567	159,772
Mallrat dhe Shërbimet	131,250	141,371	139,134	132,739	156,401
Shërbimet komunale	6,450	1,220	1,220	3,486	11,569
Investimet Kapitale	-	-	-	49,890	43,359

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte reduktuar për 3,825€. Fillimisht më rishikim të buxhetit ishte reduktuar për 644€, ndërsa me pas me vendimin e Ministrit të Financave për kursime buxhetore ishte reduktuar edhe për 3,181€;
- Te mallrat dhe shërbimet buxheti final ishte rritur për 10,121€, si rezultat i pranimit të donacioneve; dhe
- Buxheti final për shërbimet komunale, me vendimin e Ministrit të Financave për kursime buxhetore ishte reduktuar për 5,230€.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

3.4 Prokurimi

Rregullat e prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshinë kërkesat për t'i zvogëluar rreziqet në lidhje me vonesat në përfundimin e punëve, realizimin e kontratave sipas kushteve të parapara, për shmangien e konfliktit të interesit dhe për arritjen e vlerës për para.

Ne gjatë auditimit kemi rishikuar procesin e blerjeve përmes prokurimit për të vlerësuar nëse ASHMDHP ka zbatuar procedurat dhe i është përmbajtur dispozitave të ligjit të prokurimit publik.

Bazuar në mostrimet tona ne konkludojmë se ASHMDHP kishte kontrole të mira në menaxhimin e proceseve të prokurimit. Lidhja e kontratave ishte bazuar në konkurrencë dhe transparencë të plotë. Megjithatë ne vërejtëm se procesimi i pagesave nuk ishte bërë në pajtueshmëri me rregullat e thesarit.

Çështja 3 – Procedimi i urdhërbljerjeve pas pranimit të faturës - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Neni 22 i rregullës financiare nr. 01/2013/MF, përcakton procedurat e përgjithshme për procesimin e pagesave. Fillimisht bëhet kërkesa për blerje, urdhërblerja, raporti i pranimit e më pas fatura. Nga gjithsej 39 pagesa të testuara në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve në ASHMDHP, në 23 prej tyre urdhërbljerjet ishin procesuar pas pranimit të faturës.
- Rreziku** Kryerja e pagesave për mallra dhe shërbime para se të përcaktohen kërkesat/nevojat me urdhërbljerje mund të rezultojë që të pranohen mallra të sasisë dhe cilësisë jo të nevojshme.
- Rekomandimi 3** Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.

Çështja 4 - Vonesa në ekzekutimin e pagesave - Prioritet i mesëm

- E gjetura** ASHMDHP nuk ka arritur të kryejë pagesat në afatin e përcaktuar ligjor (Neni 37 pika 1 e rregullës financiare nr.01/2013/MF përcakton se të gjitha faturat që i pranon organizata buxhetore duhet të paguhen brenda 30 ditëve).
- Vonesat ishin vërejtur në 13 raste, mirëpo për çështje të raportimit në i kemi prezantuar tri fatura për shërbime telefonisë mobile në të cilat vonesat ishin më të theksuara (faturat ishin pranuar me datën 12 dhjetor 2014 në vlerë prej 7,413€ ndërsa ishin paguar me datë 24 prill 2015, me afro 86 ditë vonesë).
- ZKF është përgjegjës që të krijoj mekanizma të cilat mundësojnë regjistrimin e faturave të pranuar dhe të përcjellë procesimin e tyre për pagesë. Mirëpo, ASHMDHP nuk i kishte kushtuar kujdes kësaj pozite. Që nga themelimi i Institucionit ende kjo pozitë nuk është plotësuar.
- Rreziku** Vonesat në ekzekutimin e pagesave rrisin rrezikun për pagesa shtesë të dëmshpërblimeve ndaj OE. Gjithashtu, ekziston rreziku për dështimin e pagesave në vitin aktual dhe bartjen e tyre si obligime në vitin pasues.
- Rekomandimi 4** Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë mbikëqyrje të rregullt të procesit të ekzekutimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Në kategorinë e shpenzimeve tjera për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit, ne testuam disa pagesa të cilat përfshijnë shpenzimet për paga të cilat janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Bazuar në këtë ne identifikuam çështjen si në vijim:

Çështja 5 – Pagesat e pagave nga buxheti për mallra dhe shërbime – Prioritet i lartë

E gjetura Me rregullën financiare, Nr. 01/2013/MF Shpenzimi i parave publike, sipas nenit 33, Organizata buxhetore duhet të siguroj që të gjithë personat në marrëdhënie pune të paguhen përmes listës së pagave.

ASHMDHP, më vendim të Mbikëqyrësit Kryesor Shtetëror. Kishte paguar pagat e gjashtë të punësuarve² nga buxheti për mallra dhe shërbime. Vlera totale e paguar për 2015 ishte 12,063€.

Pagesat nga mallrat dhe shërbimet, ishin shkaktuar si pasojë e tejkalimit të numrit të të punësuarve në raport me numrin e buxhetuar. Gjithashtu MAP/DASHC nuk kishte aprovuar pozitat për të punësuarit shtesë sipas kërkesave të ASHMDHP-së.

Pas këshillave tona të dhëna në fazën e ndërmjetme, menaxhmenti i ASHMDHP-së kishte ndërprerë pagesën e pagave (për tre zyrtarët nga MPJ-ja) nga mallrat dhe shërbimet.

Rreziku Pagesat e tilla krijojnë mos pajtueshmëri me kërkesat ligjore, shpijnë në raportim jo të saktë të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, si dhe shkaktojnë kosto shtesë për shërbimet e ofruara.

Rekomandimi 5 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë se do të ndërpritet praktika e financimit të pagave nga mallrat dhe shërbimet. Me tutje të bëjnë përpjekje që në buxhetin e vitit në vijim të përfshihen pagat për të gjithë të punësuarit, dhe pagesa e tyre të realizohet përmes sistemit të pagave.

² Tre zyrtarë të MPJ-së, në bazë të marrëveshjes se arritur për kryerjen e shërbimeve (Shërbimeve të prokurimit, Auditimit dhe Menaxhimit të pasurisë), ndërsa me vendim të Mbikëqyrësit Kryesor Shtetëror ishin punësuar tre zyrtar brenda institucionit (dy përkthyes dhe një asistent).

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Shpenzimet për paga dhe mëditje paguhen përmes sistemit të centralizuar qeveritar. Kontrollat që operojnë në nivel të ASHMDHP-së kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listat e pagave, verifikimin e ndryshimeve të mundshme, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF. Po ashtu kemi testuar disa mostra, duke përfshirë dosjet e personelit, pajtueshmërinë e pagesave në raport me kontratat e punës, përcaktimin e lartësisë së mëditjeve të këshillit si dhe mirëmbajtjen e dosjeve të personelit.

ASHMDHP kishte menaxhuar pagat në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, me përjashtim të çështjes së prezantuar në vijim.

Çështja 6 - Mbulimi i pozitave me ushtrues detyre përtej kohës së lejuar – Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas Ligjit të Shërbimit Civil, në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, Ushtruesi i Detyrës (UD) mund të emërohet në kohëzgjatje deri në tre muaj.

Pozita e ZKF-së, në ASHMDHP që nga themelimi i institucionit mbulohet me ushtrues detyre. Nga data 17 prill 2014 deri me 16 janar 2016, UD për pozitën ZKF-së ishte Menaxheri i personelit. Ndërsa nga kjo datë e tutje është duke u menaxhuar nga tre muaj me rotacion.

Megjithatë, Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror ka bërë kërkesë shtesë për buxhet për disa vende të punës, përfshirë edhe pozitën e ZKF-së.

Rreziku Praktika e mbulimit për një kohë të gjatë të pozitave kyçe me UD rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme. Më tej pagesat të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin mund të konsiderohen të parregullta.

Rekomandimi 6 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin e procedurave të rekrutimit. Procedurat e rekrutimit duhet të fillojnë me kohë, dhe kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar më kërkesat ligjore.

3.6 Pasuritë dhe detyrimet

3.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Kjo kërkon procedura të kontrollit dhe menaxhimit të cilat vërtetojnë ekzistencën e pasurive ekzistuese dhe sigurojnë të dhëna të azhurnuara në përputhje me pasuritë e reja dhe ndryshimet e tjera.

Pasuria e neto e ASHMDHP-së sipas regjistrit kontabël ishte 117,585€, ndërsa pasuritë me vlerë nën 1,000€ ishin 38,427€.

Bazuar në testet tona ne identifikuam çështjet si në vijim.

Çështja 7 - Vonesa në regjistrimin e pasurive në regjistrin kontabël – Prioritet i mesëm

E gjetura ASHMDHP nuk kishte bërë azhurnimin e vazhdueshëm të regjistrit kontabël. Blerja e fotokopjes (Fotocopy Digital MFP Canon IRC35) në fund të vitit 2013 në vlerë prej 3,584€, nuk ishte e evidentuar. Megjithatë pas auditimit tonë (prill 2016), menaxhmenti ka marrë masa të menjëhershme dhe e kishte evidentuar në regjistrin kontabël. Kjo vlerë e pasurisë nuk ishte përfshirë në kuadër të PVF-ve për vitin 2015 edhe pse vlera e saj nuk ishte materiale.

Derisa në mungesë të sistemit e-pasuria, pasuritë nën vlerën 1,000€ mbahen në një bazë të të dhënave në Excel. ASHMDHP kishte bërë disa herë kërkesa të Ministria e Administratës Publike (MAP) për instalimin e këtij sistemi, mirëpo MAP-i nuk ka marrë kurrfarë hapi në këtë drejtim. Sipas rregullores MF Nr.02/2013, pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin “e-pasuria”.

Rreziku Informatat financiare ekzistuese mund të mos përmbushin kërkesat e kontabilitetit dhe të raportimit financiar. Kjo pamundëson një menaxhim efektiv dhe kontroll mbi pasuritë.

Rekomandimi 7 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë se kontrollet në menaxhimin e pasurisë janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Regjistrat e pasurisë duhet të azhurnohen rregullisht nga zyrtarët përgjegjës si dhe në fund të çdo viti ky regjistër duhet të harmonizohet më regjistrin e inventarizimit të pasurisë. Më tej të sigurojë se janë duke vazhduar përpjekjet (kërkesat në MAP) për instalimin e sistemit e-pasuria.

Çështja 8 – Menaxhimi jo i mirë i automjeteve - Prioritet i mesëm

E gjetura ASHMDHP nuk kishte kontrolle adekuate në menaxhimin e automjeteve. Nuk kishte evidenca të brendshme lidhur më shpenzimet e karburanteve dhe as për kilometrat e kaluara për automjete.

UA 03/2008 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë, neni 11 thekson mënyrën e raportimit nga ana e shfrytëzuesve të veturave zyrtare. Gjithashtu Vendimi nr. 04/14 i datës 24.07.2015, pika 3, thekson se pagesa mujore e shpenzimeve nuk do të procedohet pa dorëzimin e raporteve të kilometrave të kaluara/dedikimit të përdorimit si dhe mbushjeve me derivate.

Në tri mostra vërejtëm që zyrtari përgjegjës (Menaxheri i Transportit) nuk mbante raporte mbi kilometrazhin e kaluar të automjeteve dhe shpenzimeve të karburanteve. Ndërsa në dy pagesa tjera me vlerë 781€ dhe 808€ për kontratën “Furnizim me karburant për nevojat e ASHMDHP-së”, në mungesë të të dhënave të ASHMDHP-së, pagesat ishin bazuar vetëm në të dhënat e OE-së lidhur më shpenzimet e karburanteve.

Shkaku i mungesës së evidencave, ishte mos raportimi i shfrytëzuesve të automjeteve lidhur më kilometrat e kaluara dhe furnizimet me karburant, si dhe ngarkesa me punë e zyrtarit përgjegjës për menaxhimin e transportit (Pozita e Menaxherit të Transportit ishte deleguar si punë dytësore të Zyrtari i Arhivës).

Rreziku Mungesa e evidencave të kërkuara për menaxhimin dhe përdorimin e automjeteve paraqet rrezik për shfrytëzimin jo racional të tyre. Si rrjedhojë kostoja e shfrytëzimit të automjeteve mund të jetë më e lartë se kostoja normale lidhur më menaxhimin e tyre.

Rekomandimi 8 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë që menaxhimi i automjeteve bëhet në pajtueshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ. Të gjithë shfrytëzuesit e automjeteve duhet të raportojnë rregullisht lidhur me kilometrat e kaluara dhe shpenzimet e derivateve. Me tej Zyrtari Çertifikues, para çertifikimit të secilës lëndë për pagesë duhet të sigurojë që ekzistojnë të gjitha dëshmitë mbështetëse.

3.6.2 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2015 ishte 2625€.

Ne kemi testuar mënyrën e menaxhimit dhe raportimit të tyre, dhe bazuar në këtë kemi shpalosur mangësitë si në vijim.

Çështja 9 - Raportim jo i rregulltë i obligimeve të papaguara - Prioritet i mesëm

E gjetura ASHMDHP për vitin 2015 nuk ka raportuar obligimet e papaguara në pajtim me kërkesat e Rregullës financiare nr. 02/2013/MF për raportimin e obligimeve të papaguara të organizatave buxhetore. Raportimi ishte bërë vetëm për dy periudha, përfshirë muajt janar dhe dhjetor 2015.

Sipas zyrtarëve të financave, mos raportimi i obligimeve rrjedhë si pasojë e mungesës së stafit.

Megjithatë raportimi i obligimeve në muajin dhjetor, i paraqitur në PVF ishte i plotë.

Rreziku Mos raportimi i obligimeve në kohën e duhur në MF paraqet mos përmbushje të përgjegjësive ligjore të raportimit si dhe krijon paqartësi rreth gjendjes së përgjithshme financiare të Institucionit. Andaj, në mungesë të informatave të plota për nivelin e obligimeve të papaguara, mund të marrin vendime financiare joadekuate dhe të gabuara.

Rekomandimi 9 Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të siguroj se janë marrë veprimet e nevojshme për të përmirësuar mënyrën e raportimit të obligimeve, qoftë përmes trajnimit të stafit, ose përmes formave tjera.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar/do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarim material në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
4.2.1 Prokurimi	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë se Komisionet e vlerësimit bëjnë vlerësimin e drejtë të ofertave duke respektuar të gjitha kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit.	Po		
4.2.1 Prokurimi	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet sigurojë proces të mjaftueshëm të menaxhimit të shpenzimeve. Agjencia mundet ose të vazhdojë të përdorë shërbimet e prokurimit të ndonjë subjekti tjetër publik, në kuadër të një kontrate të re, ose të gjejë ndonjë formë tjetër brenda legjislacionit në fuqi.	Po		
4.2.1 Prokurimi	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të siguroj monitorim të vazhdueshëm të procesit të ekzekutimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar me rregulla financiare.			Nuk janë marrë masa. Edhe në vitin 2015 kishte vonesa në realizimin e pagesave.
4.2.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të monitoroj në vazhdimësi kontrollet në menaxhimin e pagave për të siguruar se të gjithë të punësuarit të cilët konsiderohen si persona në marrëdhënie punë sipas rregullës financiare, paguhet përmes listës së pagave.			Nuk janë marrë masa. Edhe në vitin 2015 një shumë e konsiderueshme e pagave janë paguar nga mallrat dhe shërbimet.

<p>4.2.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)</p>	<p>Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të përcjellë veprimet e ndërmarra për t'i eliminuar mospërputhjet mes listës së pagave dhe Akt emërimeve deri në harmonizimin e plotë të tyre.</p>		<p>ASHMDHP ka bërë kërkesa në MAP për të harmonizuar titujt në mes Akt emërimeve dhe listave të pagave, mirëpo MAP-i ende nuk i ka bërë harmonizimet e lartcekura.</p>	
<p>4.3.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale</p>	<p>Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror duhet të sigurojë që regjistrat e pasurisë janë azhurnuar me informata të sakta dhe të plota para përgatitjes së PVF-ve. Me tutje ky regjistër duhet të azhurnohet rregullisht më informatat e reja.</p>		<p>ASHMDHP kishte marrë masa dhe kishte evidentuar të gjitha automjetet në regjistrin kontabël, mirëpo edhe gjatë auditimit të PVF-ve të vitit 2015 vërejtëm së një fotokopje nuk ishte evidentuar.</p>	